

V E N D I M
Nr.58, datë 30.1.1995

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.175, DATË 25.4.1994 “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.479, DATË 16.9.1993 “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.276, DATË 30.6.1992 “PËR ORGANIZIMIN, PRITJEN, SHPËRNDARJEN DHE ADMINISTRIMIN E NDIHMAVE SHTETËRORE”

Me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Shtetërore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.175, datë 25.4.1994, në pikën 3 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Procedura e ankandit të shitjes së mallrave me shumicë nuk zbatohet për gjendjen e misrit (ndihmë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës) në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Shtetërore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi